

## FAKULTETI I SHKENCAVE TË NATYRËS DHE SHKENCAVE HUMANE ZHVILLOI WORKSHOP-IN NDËRKOMBËTAR ME TEMË: “**APLIKIMET E KËRKIMIT DHE METODAT E EDUKIMIT**”

Në datën 12 maj 2018, Departamenti i Matematikës, Informatikës dhe Fizikës në Fakultetin e Shkencave të Natyrës dhe Shkencave Humane, zhvilloi workshop-in ndërkombëtar me temë: *“Aplikimet e Kërkimit dhe Metodatat e Edukimit”*.

Ky seminar bashkoi studiues, kërkues shkencorë nga universitetet dhe institucionet kërkimore brenda dhe jashtë vendit, si dhe studentë të cikleve të studimit : Masterit Profesional dhe Master Shkencor në fushat e trajtuara. Në të u prezantuan 41 punime rreth zhvillimeve të reja metodologjike dhe arritjeve të fundit në matematikë, informatikë dhe fizikë. Sipas zëvendës dekanes, Dr. Lorena Margo; pjesëmarrësit në këtë workshop, shkëmbyen njohuri dhe përvoja në fushat përkatëse.









